

20241472563

## СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

### L I G J PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË REZERVAVE TË DETYRUESHME TË NAFTËS

#### Neni 1

Në Ligjin e Rezervave të Detyrueshme të Naftës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 144/14, 178/14, 199/15, 197/17 dhe 7/19 dhe (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 275/19, 150/21 dhe 236/22 ), në nenin 12 paragrafin (4) fjalët: "Këshilli Drejtues i Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës zëvendësohet me fjalët: "Drejtori i Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës me pëlqim paraparak të Ministrisë së Energjetikës, Minierave dhe Lëndëve të Para Minerale".

#### Neni 2

Neni 22 shlyhet.

#### Neni 3

Neni 23 shlyhet.

#### Neni 4

Neni 24 shlyhet.

#### Neni 5

Në nenin 25 paragrafi (1) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "me propozim të Ministrit të Energjetikës, Minierave dhe Lëndëve të Para Minerale".

Në paragrafin (2) në nënparagrafin 4 pas fjalëve: "funksioni udhëheqës" shtohen fjalët: "në fushën e energjetikës".

Pas paragrafit (3), shtohen dy paragrafë të rinj (4) dhe (5), si vijojnë:

„(4) Drejtori për punën e Agjencisë të Rezervave të Naftës dorëzon raport gjashtëmuajor dhe vjetor te Ministri i Energjetikës, Minierave dhe Lëndëve të Para Minerale . Raporti gjashtëmuajor dorëzohet jo më vonë deri më 30 korrik të vitit aktual, ndërsa raporti vjetor deri më 31 mars të vitit aktual për vitin paraparak.

(5) Drejtori shkarkohet:

1. nëse e kërkon vetë;
2. në rast të pengimit në kryerjen e funksionit për shkak të sëmundjes që zgjat më shumë se gjashtë muaj pa ndërprerje;
3. nëse është dënuar për vepër penale me burgim të pakushtëzuar prej së paku gjashtë muaj;
4. nëse përcaktohen parregullsi në punën e tij materiale dhe financiare , të cilat i kanë shkaktuar dëm Agjencisë për rezervat e detyrueshme të naftës;
5. për shkak të kryerjes joprofesionale, të njëanshme dhe të pakujdesshme të funksionit dhe të kompetencave që i janë besuar. “.

#### Neni 6

Neni 26 ndryshon si vijon:

“(1) Drejtori i Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme kryen këto detyra:

1. paraqet dhe përfaqëson Agjencinë rezervat e detyrueshme;

2. miraton Statutin e Agjencisë rezervat e detyrueshme pas pëlqimit paraprak të ministrit përgjegjës për çështjet nga fusha e energjetikës;
3. miraton akte për organizimin, sistematizimin, si dhe akte të tjera të përgjithshme të Agjencisë rezervat e detyrueshme;
4. miraton program vjetor me plan financiar për vitin aktual pas pëlqimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për punët në fushën e energjetikës;
5. përgatit dhe dorëzon raport vjetor për punën me llogarinë vjetore të Agjencisë për rezervat e detyrueshme në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
6. organizon punën dhe menaxhon shërbimet profesionale të Agjencisë për rezervat e detyrueshme;
7. miraton akte të përgjithshme dhe të veçanta për funksionimin e Agjencisë për rezervat e detyrueshme pas pëlqimit paraprak të ministrit përgjegjës për çështjet në fushën e energjetikës;
8. implementon vendime dhe akte të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të ministrisë përgjegjëse për çështjet e energjetikës;
9. Parashtron akte dhe raporte ministrisë përgjegjëse për çështje nga sfera e energjetikës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
10. dorëzon raport vjetor për punën e tij për miratim në ministrinë përgjegjëse për çështje energjetike dhe në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
11. propozon për ministrinë përgjegjëse për çështjet e energjetikës plan aksional për krijimin e rezervave të detyrueshme;
12. i propozon ministrisë përgjegjëse për çështjet në fushën e energjetikës vendim për sasinë dhe strukturën e rezervave të detyrueshme që do të mbahen në vitin aktual;
13. i propozon ministrisë përgjegjëse për punët në fushën e energjetikës rregullore për mënyrën e përcaktimit, llogaritjes, masës dhe pagesës së kompensimit për rezervat e detyrueshme, si dhe përmbajtjen, mënyrën dhe afatet për dërgimin e të dhënave për vendosjen e produktet e naftës në tregun vendas;
14. i propozon ministrisë përgjegjëse për punët në fushën e energjetikës rregullore për përcaktimin e masës së kompensimit për ruajtjen dhe avullimin e naftës dhe derivateve të naftës nga rezervat e detyrueshme;
15. i propozon ministrisë përgjegjëse për punët në fushën e energjetikës rregulloren për përcaktimin e metodave dhe procedurave për llogaritjen e importeve mesatare ditore neto dhe të konsumit mesatar ditor të brendshëm;
16. i propozon ministrisë përgjegjëse për çështjet në fushën e energjetikës vendim për procedurat dhe afatet e rinovimit, për çdo derivat naftë nga rezervat e detyrueshme veçmas, në përputhje me karakteristikat fiziko-kimike dhe karakteristikat e magazinës në të cilën ruhet. ;
17. i propozon ministrisë përgjegjëse për punët në fushën e energjisë rregullore për mënyrat dhe procedurat e llogaritjes së niveleve të rezervave të detyrueshme;
18. miraton plan vjetor për prokurimin publik;
19. merr vendime dhe kujdeset për zbatimin e prokurimeve publike;
20. kujdeset për funksionimin e ligjshëm dhe shpenzimin e burimeve financiare;
21. lidhë marrëveshje në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj dhe ligje të tjera dhe me statutin e Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme;
22. miraton akte individuale për punëmarrësit nga fusha e marrëdhënieve të punës dhe
23. kryen kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj ose me Statutin e Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme. “.

#### Neni 7

Pas nenit 26 shtohet neni i ri 26-a, si vijon:

#### "Neni 26-a

Ministria përgjegjëse për punët në fushën e energjetikës i kryen këto punë:

1. me propozim të drejtorit të Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës, përcakton mënyrën dhe procedurën për kryerjen e kontrollit mbi zbatimin e kontratave për ruajtjen dhe rinovimin e rezervave të detyrueshme të lidhura me shoqëritë tregtare - magazina;
2. me propozim të drejtorit të Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës, përcakton mënyrën dhe procedurën për kryerjen e kontrollit të rezervave të detyrueshme;
3. jep pëlqim për propozimin e planit aksionar për krijimin e rezervave të detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës, të cilin e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
4. jep pëlqimin për propozim-vendimin për sasinë dhe strukturën e rezervave të detyrueshme që do të mbahen në vitin aktual, të cilin e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
5. me propozim të drejtorit të Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës, miraton rregulloren që përcakton mënyrën e përcaktimit, llogaritjes dhe masës së kompensimit për rezervat e detyrueshme, si dhe përmbajtjen, mënyrën dhe afatet për dërgimin e të dhënave për vendosja e produkteve të naftës në tregun e brendshëm;
6. me propozim të drejtorit të Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës, miraton rregulloren për masën e kompensimit për ruajtjen dhe avullimin e naftës dhe derivateve të naftës nga rezervat e detyrueshme;
7. me propozim të drejtorit të Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës, miraton rregullore për përcaktimin e metodave dhe procedurave për llogaritjen e importeve mesatare neto ditore dhe të konsumit mesatar ditor të brendshëm miratohen nga ministri përgjegjës për punët në fushën e energjetikës;
8. me propozim të drejtorit të Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës, miraton rregulloren për mënyrën dhe procedurat e llogaritjes së niveleve të rezervave të detyrueshme dhe
9. kryen kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj ose me Statutin e Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme.

#### Neni 8

Në nenin 36-b në paragrafin (3) fjalët: "Këshilli Drejtues i Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës" zëvendësohet me fjalët: "Drejtori i Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës me Ministrinë e Energjetikës, Minierave dhe Lëndëve të Para Minerale".

#### Neni 9

Në nenin 36-b në paragrafin (1) fjalët: "Këshilli Drejtues i Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës" zëvendësohet me fjalët: "Drejtori i Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës me Ministrinë e Energjetikës, Minierave dhe Lëndëve të Para Minerale".

#### Neni 10

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji i pushon mandati drejtorit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Rezervave të Detyrueshme të Naftës.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në afat prej tre muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji do të emërojë drejtorin e ri.

Neni 11

Aktet nënligjore të miratuara në pajtim me Ligjin për rezervat e detyrueshme të naftës (Gazeta zyrtare e RM numër 144/14, 178/14, 199/15, 197/17 dhe 7/19 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut me numër 275/19, 150/21 dhe 236/22), deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji jo më vonë se gjashtë muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.